

PHILIPS

**Brenda
veshit**

Seria 4000

TAPN402



Manuali i përdoruesit

Regjistroni produktin dhe merrni mbështetje në
www.philips.com/support

Përmbajtja

| | | |
|---|------------------------------------|---|
| 1 | Udhëzime të rëndësishme sigurie | 2 |
| | Siguria e të dëgjuarit | 2 |
| | Informacion i përgjithshëm | 2 |

| | | |
|---|--|---|
| 2 | Kufjet tuaja me Bluetooth me përdorim brenda veshit | 3 |
| | Çfarë ka në kuti | 3 |
| | Pajisje të tjera | 3 |
| | Përmbledhje për kufjet tuaja me Bluetooth | 4 |

| | | |
|---|---|---|
| 3 | Fillimi | 5 |
| | Karikoni baterinë | 5 |
| | Çiftoni kufjet me telefonin tuaj celular | 5 |

| | | |
|---|--|---|
| 4 | Përdorimi i kufjeve | 6 |
| | Lidhja e kufjeve me një pajisje Bluetooth | 6 |
| | Kontrollimi i telefonatave dhe muzikës | 6 |

| | | |
|---|------------------|---|
| 5 | Të dhëna teknike | 8 |
|---|------------------|---|

| | | |
|---|---|----|
| 6 | Njoftim | 9 |
| | Deklarata e konformitetit | 9 |
| | Asgjësimi i produktit dhe baterisë së vjetër | 9 |
| | Heqja e baterisë së brendshme | 9 |
| | Përputhshmëria me EMF-në | 9 |
| | Informacione mjedisore | 10 |
| | Njoftimi i përputhshmërisë | 10 |

| | | |
|---|-----------------|----|
| 7 | Markat tregtare | 11 |
|---|-----------------|----|

| | | |
|---|-----------------------|----|
| 8 | Pyetje të bëra shpesh | 12 |
|---|-----------------------|----|

1 Udhëzime të rëndësishme sigurie

Siguria e të dëgjuarit



Rrezik

- Për të shmangur dëmtimin e të dëgjuarit, kufizoni kohën që përdorni kufjet në volume të larta dhe vendoseni volumin në një nivel të sigurt. Sa më lart të jetë volumi, aq më e shkurtër është koha e të dëgjuarit të sigurt.

Sigurohuni të ndiqni udhëzimet e mëposhtme kur i përdorni kufjet.

- Dëgjoni në volume të arsyeshme për periudhave kohore të arsyeshme.
- Kujdes të mos rregulloni vazhdimisht volumin lart pasi të dëgjuarit tuaj përshtatet.
- Mos e ngrini volumin aq lart që të mos dëgjoni çfarë ndodh përreth.
- Ju duhet të përdorni kujdes ose të ndërpritni përkohësisht përdorimin në situatave të mundshme të rrezikshme.
- Presioni i tepërt i tingullit nga kufjet tuaja të veshit dhe të kokës mund të shkaktojë humbjen e të dëgjuarit.
- Përdorimi i kufjeve me të dy veshët e mbuluar ndërsa drejtoni automjetin nuk rekomandohet dhe mund të jetë e paligjshme në disa zona ndërsa drejtoni automjetin.
- Për sigurinë tuaj, shmangni shpërqendrimet nga muzika ose telefonatat ndërsa jeni në trafik ose në mjedise të mundshme të rrezikshme.

Informacion i përgjithshëm

Për të shmangur dëmtimin ose keqfunksionimin:

Kujdes

- Mos i ekspozoni kufjet ndaj nxehtësisë së tepërt
- Mos i hidhni në tokë kufjet.
- Kufjet nuk duhet të ekspozohen ndaj pikave ose stërkalave.
- Mos i lejoni kufjet të zhyten në ujë.
- Mos përdorni agjentë pastrimi që përmbajnë alkool, amoniak, benzinë, ose gërryes.
- Nëse nevojitet pastrim, përdorni një leckë të butë, nëse është e nevojshme, me një sasi të ulët uji ose sapun të butë të shkrirë, për të pastruar produktin.
- Bateria e integruar nuk duhet të ekspozohet ndaj nxehtësisë së tepërt siç është drita e diellit, zjarri ose të ngjashme.
- Rrezik shpërthimi nëse bateria është zëvendësuar në mënyrë të gabuar. Zëvendësoni vetëm me të njëjtin tip ose me tip ekuivalent.

Lidhur me temperaturat e përdorimit dhe ruajtjes dhe lagështisë


- Përdoreni ose ruajeni në një vend ku temperatura është midis -15°C (5°F) dhe 55°C (131°F) (lagështia relative deri në 90%).
- Jeta e baterisë mund të jetë më e shkurtër në kushte temperature të larta ose të ulëta.

2 Kufjet tuaja me Bluetooth me përdorim brenda veshit

Urime për blerjen tuaj dhe mirësevini te Philips! Për të përfituar plotësisht nga mbështetja që ofron Philips, regjistroni produktin në www.philips.com/welcome. Me këto kufje Philips me valë me përdorim brenda veshit, ju mund:

- të bëni telefonata të rehatshme pa lidhje me tel dhe me duar të lira;
- të dëgjoni dhe kontrolloni muzikë pa lidhje me tel;
- të kaloni mes telefonatave dhe muzikës.


Çfarë ka në kuti




Kufje Philips me Bluetooth me përdorim brenda veshit Philips TAPN402



Kupa rezervë prej gome për veshët x 2 çifte



Kabllo karikimi USB (vetëm për karikim)



Kabllo audio me spinë USB





Udhëzues i nisjes së shpejtë

Pajisje të tjera

Një telefon celular ose pajisje (si notebook, PDA, adaptorë Bluetooth, aparate MP3 etj.) e cila ka Bluetooth dhe është e pajtueshme me kufjet (shiko “Të dhëna teknike” në faqen 8).

Përmbledhje për kufjet tuaja me Bluetooth



- ①  (Ndezja / Fikja / Çiftimi)
- ② Vendi i karikimit micro USB
- ③ Butoni i kontrollit të volumit / këngës
- ④ Treguesi LED
- ⑤ Mikrofoloni

3 Fillimi

Karikoni baterinë

Shënim

- Para se t'i përdorni kufjet për herë të parë, vendosini kufjet në kasën e karikimit dhe karikoni baterinë për 2 orë që bateria të ketë kapacitet dhe jetëgjatësi optimale.
- Përdorni vetëm kabllon origjinale të karikimit me USB për të shmangur dëmtimet.
- Mbaroni telefonatën para se të karikoni kufjet, pasi lidhja e kufjeve për karikim do t'i fikë ato.

Kutia e karikimit

Lidhni kabllon e dhënë USB të karikimit me:


- Sloti i karikimit të USB-së mikro në kufjet dhe;
 - Porta e karikimit/USB-së në një kompjuter.
- ↳ LED-i bëhet i kuq gjatë karikimit dhe fiket kur kufjet janë të karikuara plotësisht.

Këshillë

- Normalisht, një karikim i plotë zgjat 2 orë.

Çiftoni kufjet me telefonin tuaj celular

Para se të përdorni kufjet me telefonin celular për herë të parë, çiftojeni me një telefon celular. Një çiftim i suksesshëm vendos një lidhje unike të koduar midis kufjeve dhe telefonit celular. Kufjet ruajnë 8 pajisjet e fundit në memorie. Nëse përpiqeni të çiftoni me shumë se 8 pajisje, pajisja e çiftuar më e para zëvendësohet me të rene.

- 1 Sigurohuni që kufjet të jenë karikuar plotësisht dhe të fikura.
- 2 Shtypni dhe mbajeni  për 5 sekonda derisa LED-i blu dhe i kuq të ndriçojnë me alternim.
 - ↳ Kufje mbetet në modalitetin e çiftimit për 2 minuta.
- 3 Sigurohuni që celulari të jetë i ndezur dhe që të jetë aktivizuar veçoria Bluetooth.
- 4 Çiftoni kufjet me telefonin celular. Për informacione të detajuara, referojuni manualit të përdorimit të telefonit tuaj celular.

Shembulli i mëposhtëm ju tregon se si të çiftoni kufjet me telefonin celular.

- 1 Aktivizoni veçorinë Bluetooth të telefonit tuaj celular, zgjidhni **Philips PN402**
- 2 Formoni fjalëkalimin e kufjeve "0000" (4 zero) nëse kërkohet. Për ata telefona celularë që kanë Bluetooth 3.0 ose më të lartë, nuk ka nevojë të vendoset fjalëkalim.



Philips PN402

4 Përdorimi i kufjeve

Lidhini kufjet me pajisjen tuaj me Bluetooth

- 1 Ndizni telefon celular/pajisjen Bluetooth.
- 2 Shtypni dhe mbani butonin ndezur/fikur për të ndezur kufjet.
 - ↳ LED blu qndron ndezur për 3 sekonda.
 - ↳ Kufjet lidhen automatikisht me telefonin celular/pajisjen Bluetooth të lidhur më së fundi. Nëse pajisja e fundit nuk është e disponueshme, kufjet do të hyjnë në modalitetin e çiftimit.

Këshillë

- Nëse ndizni telefonin celular/pajisjen Bluetooth ose aktivizoni veçorinë Bluetooth pasi të ndizni kufjet, duhet të rilidhni përsëri manualisht kufjet dhe telefonin celular/pajisjen Bluetooth.

Shënim

- Nëse kufjet nuk lidhen me asnjë pajisje Bluetooth brenda 8 minutash, ato do të fikën automatikisht për të kursyer baterinë kur ANC është i fikur ose kur janë në modalitet pritjeje.

Lidhja me tel

Ju mund të përdorni kufjet edhe me kabllon audio të furnizuar. Sigurohuni që kufjet janë të ndezura para se të përdorni kabllin audio. Lidhni kabllon audio të furnizuar me kufjet dhe pajisjen e jashtme audio.

Këshillë

- Butonat e funksionit do të çaktivizohen kur përdorni modalitetin "line-in".

Menaxhoni telefonatat dhe muzikën

Ndezur/fikur

| Detyra | Butoni | Funksionimi |
|-----------------|---|---|
| Ndizini kufjet. | Ndezur/fikur, kontrolli i muzikës/telefonatës | Shtyp dhe mbaj për 3 sekonda. |
| Fik kufjet. | Ndezur/fikur, kontrolli i muzikës/telefonatës | Shtyp dhe mbaj për 5 sekonda. ↳ Drita LED blu pulson 1 sekondë dhe zbehet. |

Kontrolli i muzikës

| Detyra | Butoni | Funksionimi |
|-------------------------|---|----------------|
| Luaj ose ndalo muzikën. | Ndezur/fikur, kontrolli i muzikës/telefonatës | Shtyp njëherë. |
| Rregullo volumnin. | +/- | Shtyp njëherë. |
| Gjurma tjetër. | + | Shtyp gjatë. |
| Gjurma e mëparshme. | - | Shtyp gjatë. |

Kontrolli i telefonatës

| Detyra | Butoni | Funksionimi |
|--|---|----------------|
| Prano/refuzo një telefonatë. | Ndezur/fikur, kontrolli i muzikës/telefonatës | Shtyp njëherë. |
| Ndërro telefonuesin gjatë telefonatës. | Ndezur/fikur, kontrolli i muzikës/telefonatës | Shtyp dy herë. |

Statusi i treguesit të kufjeve të tjera

| Statusi i kufjeve | Treguesi |
|---|---|
| Kufjet janë të lidhur me një pajisje Bluetooth, ndërsa kufjet janë në modalitetin në gatishmëri ose ndërsa po dëgjoni muzikë. | Drita LED blu është e ndezur. |
| Kufjet janë gati për çiftim. | LED-i ndriçon blu dhe kuq me alternim. |
| Kufjet janë të ndezura por jo të lidhura me një pajisje Bluetooth. | Drita LED blu dhe e kuqe pulson me ngadalë. Nëse nuk mund të bëhet asnjë lidhje, kufjet do të fiken vetë brenda 8 minutash. |
| Nivel i ulët i baterisë. | Drita LED e kuqe pulson çdo 2 sekonda derisa të mbarojë energjia. |
| Bateria është karikuar plotësisht. | LED-i i kuq është fikur. |

5 Të dhëna teknike

- Koha e muzikës: 7 orë
Koha e bisedës: 7 orë
- Koha në gatishmëri: 160 orë
Koha e karikimit: 2 orë
- Bateri e karikueshme me polimere litiumi (80 mAh)
- Versioni i Bluetooth: 5.0
- Profilët e pajtueshme Bluetooth:
 - HFP (Hands-Free Profile-HFP)
 - A2DP (Advanced Audio Distribution Profile – Profili i shpërndarjes së avancuar audio)
 - AVRCP (Audio Video Remote Control Profile – Profili audio video telekomandë)
- Audio codec i mbështetur: SBC
- Diapazoni i frekuencave: 2.402-2.480 GHz
- Fuqia e transmetuesit: < 10 dBm
- Distanca e funksionimit: Deri në 10 metra
- Reduktim dixhital i jehonës dhe zhurmës
- Fikje automatike
- Portë Micro-USB për karikim
- Mbështet SBC
- Paralajmërim për bateri të ulët: i disponueshëm



Shënim

- Specifikimet janë objekt ndryshimi pa njoftim.

6 Njoftim

Deklarata e përputhshmërisë

Me anë të kësaj, MMD Hong Kong Holding Limited deklaron se ky produkt është në përputhshmëri me kërkesat thelbësore dhe dispozita të tjera relevante të Direktivës 2014/53/BE. Ju mund ta gjeni Deklaratën e Përputhshmërisë në www.p4c.philips.com.

Asgjësimi i produktit dhe baterisë së vjetër



Produkti juaj është projektuar dhe prodhuar me materiale dhe komponentë të cilësisë së lartë, të cilët mund të riciklohen dhe ripërdoren.



Ky simbol mbi produktin do të thotë se produkti mbulohet nga Direktiva Evropiane 2012/19/BE.




Ky simbol do të thotë se produkti përmban një bateri të integruar të rikarikueshme të mbuluar nga Direktiva Evropiane 2013/56/BE, e cila nuk mund të asgjësohet me mbetje normale shtëpiake. Ne ju këshillojmë fort që të dërgoni produktin në një pikë zyrtare grumbullimi ose të një qendër servisi Philips që bateria e rikarikueshme të hiqet nga një profesionit. Informohuni për sistemin lokal të ndarë për produkte elektrike ose elektronike dhe bateri të rikarikueshme. Ndiqni rregullat lokale dhe mos e asgjësoni asnjëherë produktin dhe bateritë e rikarikueshme me mbetjet normale shtëpiake. Asgjësimi i duhur i produkteve të vjetra dhe baterive të rikarikueshme ndihmon në parandalimin e pasojave negative për mjedisin dhe shëndetin e njeriut.

Hiqni baterinë e integruar

Nëse nuk ka sistem grumbullimi/riciklimi për produkte elektronike në vendin tuaj, ju mund të mbronni mjedisin duke hequr dhe ricikluar baterinë para se të asgjësoni kufjet.

- Sigurohuni që kufjet të jenë të shkëputura nga kasa e karikimit para se të hiqni baterinë.



Përputhshmëria me EMF-në

Ky produkt përputhet me të gjithë standardet dhe rregulloret e zbatueshme në lidhje me ekspozimin ndaj fushave elektromagnetike.

Informacione mjedisore

Të gjitha paketimet e panevojshme janë hequr. Jemi përpjekur ta bëjmë paketimin të lehtë për t'u ndarë në tre materiale: karton (kutia), shkumë polisteroli (amortizatori) dhe polietilen (qeset, fleta e shkumës mbrojtëse.) Sistemi juaj përbëhet nga materiale që mund të riciklohen dhe ripërdoren nëse çmontohen nga një kompani e specializuar. Lutemi, respektoni rregulloret lokale në lidhje me asgjësimin e materialeve të paketimit, baterive të harxhuara dhe pajisjeve të vjetra.

Njoftimi i përputhshmërisë

Pajisja përputhet me rregullat FCC, pjesa 15. Përdorimi është objekt i dy kushteve të mëposhtme:

1. **Kjo pajisje mund të mos shkaktojë interferencë të dëmshme, dhe**
2. **Kjo pajisje duhet të pranojë çdo interferencë të marrë, përfshirë interferencën që mund të shkaktojë përdorim të padëshiruar.**

rregullat FCC

Kjo pajisje është testuar dhe është gjetur se përputhet me kufijtë për një pajisje dixhitale Klasa B, në përputhje me pjesën 15 të rregullave FCC. Këto kufij janë projektuar për të siguruar mbrojtje të arsyeshme ndaj interferencës së dëmshme në një instalim rezidencial. Kjo pajisje gjeneron, përdor dhe mund të rrezatojë energji të frekuencës radio dhe, nëse nuk është instaluar dhe përdorur në përputhje me manualin e udhëzimit, mund të shkaktojë interferencë të dëmshme ndaj komunikimeve radio. Sidoqoftë, nuk ka garanci që interferenca nuk do të ndodhë në një instalim të veçantë. Nëse kjo pajisje shkakton interferencë të dëmshme ndaj sinjalit të radios ose televizionit, gjë e cila

mund të përcaktohet duke e ndezur dhe fikur pajisjen, përdoruesi inkurajohet që të përpiqet ta ndreqë interferencën nëpërmjet një ose më shumë prej masave të mëposhtme:

- Ndryshoni orientimin ose lëvizni antenën.
- Largojeni pajisjen nga marrësi
- Lidhni pajisjen në një prizë në një qark të ndryshëm nga ai me të cilin është lidhur marrësi.
- Konsultohuni me shitësin ose me një teknik radiosh/televizorësh me përvojë për ndihmë.

Deklarata e ekspozimit të rrezatimit FCC:

Pajisja përputhet me kufijtë FCC e ekspozimit ndaj rrezatimit të Kanadasë të përcaktuar për mjediset e pakontrolluara. Ky transmetues nuk mund të bashkë-vendoset ose përdoret së bashku me një antenë ose transmetues tjetër.

Kujdes: Përdoruesit i tërhiqet vëmendja se ndryshimet ose modifikimet e pa miratuara shprehimisht nga pala përgjegjëse për përputhshmërinë mund ta bëjë nul autoritetin e përdoruesit për të përdorur pajisjen.

Kanada:

Kjo pajisje përmban transmetues/marrës pa licencë që përputhen me RSS-në pa licencë të Kanadasë për Inovacionin, shkencën dhe zhvillimin ekonomik. Përdorimi është objekt i dy kushteve të mëposhtme: (1) kjo pajisje nuk mund të shkaktojë interferencë të dëmshme, dhe (2) Kjo pajisje duhet të pranojë çdo interferencë të marrë, përfshirë interferencën që mund të shkaktojë përdorim të padëshirueshëm të pajisjes. CAN ICES-3(B)/NMB-3(B)

Deklarata e ekspozimit të rrezatimit IC:

Pajisja përputhet me kufijtë e ekspozimit ndaj rrezatimit të Kanadasë të përcaktuar për mjediset e pakontrolluara. Ky transmetues nuk mund të bashkë-vendoset ose përdoret së bashku me një antenë ose transmetues tjetër.

7 Markat tregtare

Bluetooth

Marka e fjalës Bluetooth® dhe logot janë marka të regjistruara tregtare të zotëruara nga Bluetooth SIG, Inc. dhe çdo përdorim i këtyre markave nga MMD Hong Kong Holding Limited bëhet me licencë. Markat e tjera tregtare dhe emrat e tjerë tregtar janë të pronarëve të tyre përkatës.

Siri

Siri është një markë tregtare e Apple Inc., e regjistruar në SHBA dhe në vende të tjera.

8 Pyetjet më të shpeshta

Kufjet e mia me Bluetooth nuk ndizen.

Niveli i baterisë është i ulët. Karikoni kufjet.

Nuk i çiftoj dot kufjet e mia me Bluetooth me pajisjen time me Bluetooth.

Bluetooth është çaktivizuar. Aktivizoni Bluetooth në pajisjen tuaj me Bluetooth dhe ndizeni pajisjen me Bluetooth para se të ndizni kufjet.

Pajisja me Bluetooth nuk i gjen dot kufjet.

- Kufjet mund të jenë lidhur me një pajisje që janë çiftuar më parë. Fikni pajisjen e lidhur ose nxirreni jashtë fushës.
- Çiftimi mund të jetë rivendosur ose kufjet janë çiftuar më parë me një pajisje tjetër. Çiftoni sërish kufjet me pajisjen Bluetooth siç përshkruhet në manualin e përdorimit. (shiko "Çiftimi i kufjeve me pajisjen Bluetooth për herë të parë" në faqen 6).

Kufjet e mia me Bluetooth janë të lidhura me një telefon celular me Bluetooth stereo, por muzika luhet vetëm në boksën e telefonit celular.

Referojuni manualit të përdorimit të telefonit tuaj celular. Zgjidhni të dëgjoni muzikë nëpërmjet kufjeve.

Cilësia audio është e varfër dhe mund të dëgjohet zhurmë e çjerrë.

- Pajisja me Bluetooth është jashtë rrezes. Reduktoni distancën midis kufjeve dhe pajisjeve Bluetooth, ose hiqni pengesat midis tyre.
- Karikimi i kufjeve.

Cilësia audio është e varfër kur transmetimi nga celulari është shumë i ngadaltë, ose transmetimi audio nuk punon fare.

Sigurohuni që celulari jo vetëm mbështet (mono) HFP, por mbështet edhe A2DP dhe është i pajtueshëm me BT4.0x (ose më lart) (shiko "Të dhënat teknike" në faqen 8).

Unë dëgjoj por nuk të kontrolloj muzikën në pajisjen time Bluetooth (p.sh. luaj/ndalo/kalo përpara/mbropa).

Sigurohuni që burimi audio i Bluetooth mbështet AVRCP (shih "Të dhënat teknike" në faqen 8).

Niveli i volumit të kufjeve është shumë i ulët.

Disa pajisje me Bluetooth nuk e lidhin dot nivelin e volumit me kufjet me anë të sinkronizimit të volumit. Në këtë rast, ju duhet të rregulloni volumnin në pajisjen tuaj Bluetooth në mënyrë të pavarur për të arritur nivelin e duhur të volumit.

Nuk i lidh dot kufjet me një pajisje tjetër. Çfarë të bëj?

- Sigurohuni që Bluetooth në pajisjen e çiftuar më parë është çaktivizuar.
- Përsëritni procedurën e çiftimit në pajisjen e dytë (shiko "Çiftimi i kufjeve me pajisjen Bluetooth për herë të parë" në faqen 6).

Për mbështetje të mëtejshme, vizitoni www.philips.com/support.



Philips dhe Philips Shield Emblem janë marka të tregtare të regjistruara të Koninklijke Philips N.V. dhe përdoren me licencë. Ky produkt është prodhuar dhe shitet me përgjegjësinë e MMD Hong Kong Holding Limited ose një prej filialeve të tij, dhe MMD Hong Kong Holding Limited është garantuesi në lidhje me këtë produkt.

UM_TAPN402_00_SQ_V1.0

